



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 8056 prot.

Himarë, më 28.10. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 56, Datë 28.10/2025 ✓

PËR

**“MIRATIMIN E VENDIT TË DEPOZITIMIT DHE SISTEMIMIN E
MBETJEVE TË NGURTA, NË ZONËN E VISHËS”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjin nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”, VKM nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, VKM nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM nr.866, datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”, VKM nr.652 datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura”, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” si dhe VKB Himarë Nr.8 datë 20.08.2019 “Mbi miratimin e planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Bashkinë Himarë si dhe miratimin e vënies në dispozicion të hapësirës të stabilizimit dhe kompostimit pranë stacionit të transferimit të mbetjeve në Vumlo”: Nisur nga

relacioni i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI

1. Miratimin e projektit të **“Parkut Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta”**, i cili parashikohet të ndërtohet në zonën **“Qafa e Vishës”**, në territorin administrativ të Bashkisë Himarë” që dalin nga gërmimet e objekteve:

Vendndodhja: Qafa e Vishës, Bashkia Himarë

Sipërfaqja totale: 9 988.64 m²

Funksioni: Depozitim, përpunim dhe menaxhim logjistik i materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte.

2. Të merren të gjitha masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.
3. Ky Vendim është i vlefshëm vetëm për venddepozitimin e përkohshëm të ngurta dhe jo për projekte të tjera ndihmëse.
4. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKTU/Bashkia) dhe akteve ligjore në fuqi.
5. Ky Vendim është i vlefshëm pasi Bashkia të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
6. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
7. Të mbahen parasysh kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Përmiratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
8. Zotëruesit e mbetjeve të ngurta janë të detyruar të depozitojnë mbetjet e ngurta në venddepozitimin e përkohshëm, kundrejt tarifës për ton mbetje të propozuar të miratuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
9. Masa e mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga operacionet e gërmimit, të sistemohen në vendin e caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
10. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
11. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
12. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjekteve.
13. Të bëhet pastrimi i mjetet të punës para daljes nga venddepozitimi për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
14. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë në mjedisin ujor dhe atë tokësor, pranë objektit.
15. Ndalohet rreptësisht ndryshimi i rrjedhës ujore të lumit në afërsi të

venddepozitimit.

16. Subjektet të realizojnë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tyre.
17. Subjektet të ndjekin me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
18. Të zbatohetn kushtet teknike për rrethimin e zonës së venddepozitimit, në mënyrë të tillë duke mbrojtur mjediset ujor dhe atë tokësor nga rrëshkitjet e mbetjeve inerte si dhe nga erozioni.
19. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
20. Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur nje imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
21. Pas përfundimit të depozitimit të mbetjeve të ngurta, të kryhen punime sistemuese dhe rehabilituese që të përfshijnë: Nivelim, rrafshim dhe sistemim të sipërfaqes së venddepozitimit.
22. Në përfundim të punimeve rehabilituese dhe mbylljes së venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte, të dorëzohet pranë AKM-së raporti përfundimtar i gjendjes së mjedisit.
23. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Himarë.
24. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

KRYETARI
Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDESKRYETARI

Erifili Berberi





PARKU LOGJISTIK

PER

„ DEPOZIMIN E MBETJEVE TE NGURTA“



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 8056/2 prot.

Himarë, më 28.10.2025

RELACION TEKNIK

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Himarë – *Projekti i Parkut Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta (Qafa e Vishës)*

PËRSHKRIM TEKNIK I DETAJUAR

Park Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta

Vendndodhja: Bashkia Himarë (Qafa e Vishës

Sipërfaqja totale: 9 988.64 m²

Funksioni: Depozitim, përpunim dhe menaxhim logjistik i materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte.

1. Qëllimi i projektit

Ky relacion i drejtohet Këshillit Bashkiak Himarë me qëllim informimin dhe marrjen e vendimit për miratimin e projektit të **“Parkut Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta”**, i cili parashikohet të ndërtohet në zonën **Qafa e Vishës**, në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një **qendre të përqendruar për depozitimin, përpunimin e përkohshëm dhe menaxhimin logjistik të materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte**, të cilat gjenerohen nga aktivitetet ndërtimore dhe shërbimet komunale në zonë.

Projekti synon të përmirësojë ndjeshëm **efikasitetin e shërbimeve publike, reduktimin e ndotjes mjedisore dhe organizimin e kontrolluar të flukseve të mbetjeve**.

2. Vendndodhja dhe karakteristikat e përgjithshme

- **Vendndodhja:** Qafa e Vishës, Bashkia Himarë
- **Sipërfaqja totale:** 9 988.64 m²
- **Funksioni:** Depozitim, përpunim dhe menaxhim logjistik i materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte

3. Përshkrimi teknik i projektit

Projekti parashikon ndërtimin e një **parku logjistik të organizuar në zona funksionale**, si më poshtë:

Zona funksionale	Sipërfaqe (m ²)	Përshkrim teknik
A. Hyrja dhe kontrolli	~500	Portë automatike, kabinë roje, sistem peshe elektronik
B. Depozitimi i mbetjeve inerte	~4 000	Zonë betonuar me ndarje për kategori të ndryshme materiali
C. Selektimi dhe magazinimi i përkohshëm	~1 800	Strukturë metalike me kontenierë për materiale riciklueshme
D. Parkimi i mjeteve komunale	~1 000	Zonë për parkim dhe ruajtje pajisjesh
E. Ndërtesa ndihmëse	~300	Ndërtesë me panele sanduiç me zyra, magazinë dhe tualete
F. Rrugë dhe qarkullime	~1 200	Rrugë të brendshme me asfalt bituminoz
G. Gjelbërim dhe mbrojtje vizuale	~1 000	Brez me pemë dhe shkurre autoktone

Zgjidhjet ndërtimore përfshijnë:

- Rrafshim dhe sistemim të terrenit;
- Strukturë mbajtëse me beton C20/25 për sheshet e depozitimit;
- Ndriçim me projektorë LED 150W;
- Rrethim metalik me panele sanduiç dhe portë automatike me logo të Bashkisë Himarë;
- Ndërtesë ndihmëse me strukturë metalike HEB dhe izolim termik poliuretani.

4. Sistemet teknike

- **Ujësjiellësi:** lidhje me rrjetin ekzistues, rezervuar 10 m³ dhe kanalizime fekale me gropë septike;
- **Energjia elektrike:** linjë 3-fazore 380V, nënstation 15 kVA, ndriçim i jashtëm me projektorë LED;
- **Siguria:** sistem kamerash CCTV, sinjalistikë rrugore, hidrante dhe pika emergjence.

5. Aspekti mjedisor

Projekti respekton kërkesat e **VKM nr. 99/2015** dhe të **Ligjit nr. 10463/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”**, duke garantuar:

- Riciklim të materialeve ndërtimore; Kanalizim të kontrolluar të ujërave të ndotura dhe të shiut;
- Breza gjelbërimi për uljen e zhurmës dhe pluhurit.
- Kanalizim të kontrolluar të ujërave të ndotura dhe të shiut;
- Breza gjelbërimi për uljen e zhurmës dhe pluhurit.

6. Verifikimi kadastral i pronësisë së truallit

Në kuadër të procesit të verifikimit të pronësisë, Bashkia Himarë ka kërkuar informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresë nr. 7880 prot., datë 20.10.2025.

Në përgjigje, është marrë shkresa zyrtare nr. 10467/1 prot., datë 25.10.2025, sipas së cilës pasuritë me nr. 3/606, 3/532, 3/666 dhe 2/559, ndodhen në zonën kadastrale 3844 (Vuno) dhe janë në pronësi shtet.

Nga analiza e planvendosjes rezulton se:

- Pasuritë nr. 3/606, 3/532 dhe 3/666 përfshihen pjesërisht në sipërfaqen e propozuar për ndërtimin e parkut logjistik;
- Pasuria nr. 2/559 (lloji "përrua", sip. 16,919 m²) nuk ndodhet brenda kufijve të sipërfaqes së propozuar dhe për rrjedhojë nuk përfshihet në projekt.

Kjo verifikon se e gjithë zona e projektuar për zhvillim është në truall shtetëror, duke përmbushur kërkesat ligjore për pronësinë dhe përdorimin publik të territorit.

7. Përfundime dhe propozim

Bazuar në analizat teknike, mjedisore dhe kadastrale, projekti i **Parkut Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta** përfaqëson një ndërhyrje të domosdoshme për:

- përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe materialeve inerte në territorin e Bashkisë Himarë;
- krijimin e infrastrukturës për depozitimin e kontrolluar të tyre;
- mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale.

Në këtë kuadër, i propozohet **Këshillit Bashkiak Himarë** të miratojë projektin teknik dhe vendndodhjen e tij, si pjesë e investimeve strategjike në sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe territorit.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

DREJTORI

Klodi Ajazaj

Konc. Anida Xhani

Konfirmoi : Alba Metoja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 3009 prot.

Himarë, më 28.05. 2025

Lënda : Kërkësë për informacion

ADMINISTRATËS RAJONALE TË ZONAVE TË MBROJTURA VLORE
Rruga Sazani, ish zyrat e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor
Vlorë

Kërkojmë informacion për sipërfaqen me koordinata në sistemin KRGJSH si më poshtë

Nr.	Koordinata X	Koordinata Y
1	475842.640	4444690.316
2	475578.041	4444659.516
3	475575.941	4444440.416
4	475861.541	4444527.216

Është pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura apo monumenteve të natyrës në qarkun Vlorë?


Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

Konceptoi: Sokrat Kreku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA VLORË
SEKTORI MONITORIMIT

Nr. 163 / Prot.

Vlorë, më 15.04. 2025

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. VANGJEL TAVO
BASHKISË HIMARË

Në bazë të Ligjit 81/2027 “Për Zonat E Mbrojtura” i ndryshuar, Vendim nr. 102, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe shkresës me nr.3009 Prot, datë 09.04.2025, protokolluar pranë AdZM Vlorë me Nr 163 Prot, datë 14.04.2025 ju shprehemi se:

Pas shqyrtimit të kërkesës së bërë nga ana juaj drejtuar AdZM Vlorë dhe koordinatave të bashkëlidhura, ju shprehemi se “sipërfaqja e objektit të kërkuar ndodhet jashtë Zonave të Mbrojtura dhe nuk prek Monumentet e Natyrës të qarkut Vlorë.


Bashkëlidhur dërgohet harta përkatëse sipas kërkesës në ASIG Geoportal.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.



DREJTOR I AdZM VLORË
MARTIN GORICI





Harta sipas kordinatave të kërkesës e verifikuar në ASIG Geoportal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 1341 prot.

Himarë, më 20.10.2025

PROCESVERBAL

PËR

“Dëgjese publike me banorët për miratimin e vendit të depozitimit të dhera/inerte, në zonën e Vishës që dalin nga gërmimet e objekteve, me vendndodhje në bashkinë Himarë”

Njësia administrative	Data	Ora	Vendi ku zhvillohet dëgjesa	Struktura organizatore
Himarë	20.10.2025	12:00	Në qendër të fshatit vuno, Himarë	Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

PJESËMARRJA		
Nga Bashkia Himarë	Nga komuniteti	
	Lista me pjesëmarrës bashkëngjitur	
Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit-Z. Klodi Ajazaj		
Drejtoria Juridike- z. Ardit Muhametaj		
Përfaqësues të drejtorisë së Pyje kullotave		

Përfaqësue nga kryesia e fshatit Vuno		
Të tjerë		

- **Tematika për diskutim:**

Diskutim për dakortësinë në lidhje me vendndodhjen e propozuar për depozitimit të dhera/inerte, në zonën e Vishës që dalin nga gërmimet e objekteve.

- **Zhvillimi i dëgjësës**

Dëgjesa publike konsiston kryesisht me marrjen e mendimeve të banorëve dhe të interesuarve në lidhjen me vendndodhjen e propozuar për depozitimit të dhera/inerte, në zonën e Vishës që dalin nga gërmimet e objekteve.

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë- Ju falenderojmë për pjesëmarrjen. Jemi këtu për te diskutuar dhe për të marr mendimeve për këtë propozim me iniciator projektues e Bashkia Himarë dhe përfitues komuniteti i bashkisë Himarë.

Komentet e banorëve dhe përfaqësuesve të tjerë:

Z.Marko Çakalli- Si përfaqësuese i fshatit kërkoj të marr informacion dhe të jap mendim që këto prona janë ende të pa pajisuara me dokument pronësor. Jap mendim që të realizohet procesi i regjistrimit përfundimtar të këtyre pasurive që preken nga ky projekt në mënyrë që më tej të realizohet shpronësimi i duhur i pjesës që preket nga projekti.

Z. Koço Bala- Jam banor i kësaj zone dhe i kërkoj Bashkisë që të shikojë dhe alternativa të tjera për zhvillimin e këtij projekti pasi në atë krah të rrugës ka burime ujore dhe pretendues për pronësi.

Në vazhdimësi të bashkëbisedimit përfaqësuesit e Bashkisë shprehën inpenjimin maksimal që së bashku me organet përkatëse ASHK dhe ATP të konfirmojnë çdo dokumentacion pronësie në këtë fazë të projekt idesë përpara se të ndërmarrin veprime të tjera.

Banorë të zonës - Të gjendet mundësia e një vendi tjetër pasi ujrat që shkarkohen në det dhe krijojnë ndotje gjithandej sidomos në zonën e Jalit. Ngre shqetësimin dhe për kanalet kulluese që jan të bllokuara.

Z. Leonard Andoni – Ky projekt duhet që krahas lehtësive që krijon për ndërtuesit të përkthehet në investime për fshatin Vuno.

Z. Irakli Kongjini - Bashkia duhet të lidhë marrëveshje me investitorët që depozitojnë inerte që të invenstojnë në rrugët dhe kanalet e fshatit.

Z. Koço Bala- Në parim jemi darkot me projektin që keni propozuar që të bëhet në zonën e Vishës por duhet zgjidhur dhe problemi i rregjistrimit të tokave në mënyrë që të shpronësohen dhe banorët të cilët i prek ky projekt.

Përfaqësues të urbanistikës **z. Klodi Ajazaj** së bashku me përfaqësuesin e drejtorisë juridike **z. Ardit Muhametaj** bënë një prezantim të shkurtër teknik të propozimit të gjurmës në hartë ku paraqitën dhe hartën treguese të zonës që propozohet të preket nga ky projekt, duke marrë parasysh opinionet e interesuarve që kanë pronat në këto gjurmë.

Kryeplaku i Fshatit - Deri sa të gjitha pronat që prek ky projekt të jenë verifikuar në bazë dhe të mendimeve të banorëve të fshatit, nuk jemi darkod të nisi ky projekt i propozuar.

Përfundimi i dëgjësës:

Përfaqësuesit e Bashkisë, shprehën angazhimin e tyre për t'u adresuar të gjitha shqetësimet e ngritura para vazhdimit të projektit. Pjesëmarrësit u falenderuan për mendimet e dhëna dhe u theksua se projekti do të realizohet vetëm pasi të zgjidhen verifikimet e pronësisë dhe të tjera të shprehura nga banorët.

Mbyllja:

Takimi përfundoi me falënderimin e pjesëmarrësve dhe mbledhjen e nënshkrimeve të tyre.

DREJTORI I DREJTORISE SË PLANIFIKIMIT

DHE ZHILLIMIT TË TERRITORIT

Klodi Ajazaj

MBAJTËS I PROCESVERBALIT

DREJTORI JURIDIK

Ardit Muhametaj

Foto dhe listëprezenca nga dëgjesa publike datë 20/10/2025 ora:11:00




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Vuno, më 29/10/2025

Listeprezenca

Dëgjese publike "Miratimin e vendit të depozitimit të dherave/inerte, në zonën e Vishës" që dalin nga gërmimet e objekteve: "datë 20.10.2025, ora-11:00, vendi: Fshati Vuno, Himarë.

Nr	Emër	Mbiemër	Nr tel	Firma
1	Mina	Rizaj	0682128445	MR.
2	Eli	Kokusha	0692185333	EL
3	Luci	Milo	0695203064	Luci
4	Ylli	Kokusha	0692095555	Ylli
5	Filip	dhoni	0696247924	Filip
6	Marko	Calabli	0622348571	Marko
7	Fair	Andoni	0672641731	Fair
8	Dani	Pristi		Dani
9	Robert	Eso	0677520298	Robert
10	Armando	Andoni	0694497027	Armando
11	Aleksander	Calabli	0694786869	Aleksander
12	Leonard	Andoni	0675799148	Leonard
13	Przem	Bala	0692885245	Przem
14	Hektor	Gjika	+306938331514	Hektor
15	Irrelbi	Shylli	069390039	Irrelbi
16				
17				
18				
19				
20				







REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE Vlorë

Nr. 10467/1 Prot.

Vlorë, më 25.10.2025

Lënda : Kthim-përgjigje

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 7880 prot., dt 20.10.2025 protokolluar në DVASHK Vlorë me nr. 10467 datë 22.10.2025 me objekt kërkesë për informacion për pasuri nr.3/606,3/532,2/559 dhe 3/666 sqarojmë se ,

Nga verifikimi i kryer në bazë të planvendosjes përcjell nga ana juaj rezultoi se pasurite me nr. 3/606,3/532,2/559 dhe 3/666 janë në zk.3844 Vuno për të cilat po ju vendosim në dispozicion kartelat e pasurive përkatëse dhe hartën treguese.

Bashkëlidhur kartelat e pasurive dhe hartën treguese.

- nr.2/559 vol.4 fq.84 zk.3844 e llojit perrua me sip.16919 m2 ne pronesi shtet
- nr.3/666 vol.8 fq.204 zk.3844 e llojit kullote me sip.24963 m2 ne pronesi shtet
- nr.3/532 vol.7 fq.250 e llojit kullote me sip.288438 m2 ne pronesi shtet
- nr.3/606 vol.8 fq.36 me sip.4685 m2 e llojit rruge ne pronesi shtet.

DREJTOR

Genc Deromemaj

Me Urdhër dhe Delegim

MaCida
Xhella

ZV/Drejtor

Sokol Shehaj

Sokol
Shehaj

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë

Data: 2025/10/25 12:23:44 v.02:00

34pY Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Vlorë

Adresa postare : Rruga Transballkanike Vlorë



nim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
jë procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)



476242.255
4444210.138

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësimore të ofruara nga autoritetet publike për qelqesë.

Përgjegjësitë për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 50 100 200 m

Sistemi Koordinativ: KROQSH

Projekti: KROQSH

Rendi 1 (Kroqsh)

476242.255
4444210.138

Legjenda

- Parcelat
- Kadastrele (AI BSCAD)
- Parcelat
- Perforimi
- Trase:
- ANTIKE, APA
- BAZE USHTAR
- ERODUAR, ER
- KARRIER, KENI
- LULISHTE, LUK
- PA FRUT, PAUL
- PUS UJI, PYLL
- REPART USHT
- Rendi 1 (Kroqsh)

[Signature]

[Signature]

[Signature]



BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

HARTA E VENDOSJES SE PARKUT LOGJISTIK TË GRUMBULLIMIT TË INERTEVE

HIMARË, TETOR 2025



Legjende

Sipërfaqe parcele 9988.67m²
Mur rrethues 125m linear



BASHKIA HIMARË

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
PAMJE TREDIMENSIONALE**

HIMARË, TETOR 2025





BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RRETHIMI I PARKUT LOGJISTIK TE GRUMBULLIMIT TE INERTEVE

HIMARË, TETOR 2025



Ngjyra	Kodi RAL
E bardhë	RAL9016
Blu e errët	RAL5004
Blu e thellë	RAL5017
Blu e lehtë	RAL5012
Blu e mesme	RAL5005
E artë	RAL1036